



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Këshilli i ministrave

V E N D I M

Nr. 742, datë 7.11.2007

PËR

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË NJËSIVE EKONOMIKE, QË
DUHET TË ZBATOJNË STADNRDET NDËRKOMBËTARE TË
KONTABILITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Subjekte të zbatimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit janë subjektet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar.
2. Njësitë e tjera ekonomike, të cilat nuk janë objekt i ligjit të sipërpërmendur, do të jenë subjekt i zbatimit të standardeve ndërkombëtare, kur tejkalojnë, njëkohësisht, për dy vitet e fundit, këto kufij:
 - a) Të ardhurat vjetore, në shumën 1 250 000 000 (një miliard e dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë;
 - b) Numri mesatar i të punësuarve, mbi 100 punonjës në vit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për mbikqyrjen e zbatimin e pikës 2, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

SALI BERISHA

MINISTRI I FINANCAVE

RIDVAN BODE